



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 439 Prot.

Tiranë, më datë 24.08.2023

**VENDIM**  
**Nr. 439, datë 24.08.2023**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 24.08.2023:

**VENDOSI:**

- Miratimin e projektit “Rikonstruksion i Godinës ekzistuese +shtesë anësore dhe shtesë kati”, Brenda Kufirit Ansambël Historik Urban Voskopojë, me aplikues Aleko Papakozma dhe zhvillues Aleko Bërdilla:
  - Me kusht që gjatë zbatimit të punimeve të përdoret tipologjia “tjegulla vendi”;
- Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për Trashëgiminë Kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2;
- Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
- Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
- Ndaj vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Elva MARGARITI**

**SEKRETAR**  
**Klesta QIRICI**

Klesta  
Qirici

Digitally signed by  
Klesta Qirici  
Date: 2023.08.25  
13:27:18 +02'00'

Elva  
Margariti

Digitally signed by Elva  
Margariti  
Date: 2023.08.25  
13:39:25 +02'00'